



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 3.6.2021

Lënda: Parashtrime mbi dokumentacionin e përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në datat: 28.5.2021, 31.5.2021, 1.6.2021, 2.6.2021, që i përkasin ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 183, datë 19.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Çano

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

1. Në seancën gjyqësore të datës 14.5.2021, ju vendosët çeljen e hetimit gjyqësor në bazë të nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, neneve 41, pika 4, 43, pikat 4 dhe 45 të ligjit nr. 84.2016 dhe, në funksion të hetimit, u kërkua dokumentacion dhe informacion shtesë nga këto institucione: (i) Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, (ii) Drejtoria Qendrore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; (iii) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat; (iv) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë; (v) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe (vi) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. Në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për denoncimin e paraqitur në Kolegj, kryesisht u kërkuan të dhëna nga: (i) Agjencia Shtetërore e Kadastrës Gjirokastër; (ii) Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve Gjirokastër (ii.1) Vlorë e (ii.2) Lushnjë.

3. Më datë 31.5.2021, 1.6.2021, dhe dje, 2.6.2021, në Institucionin e Komisionerëve Publikë janë protokolluar shkresat me nr. ***/*** prot., nr. ***/*** prot., nr. ***/*** prot. dhe nr. ***/***, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me anë të cilave janë përcjellë, si shkresat dërguar institucioneve të sipërpërmendura, ashtu edhe përgjigjet e administruara pranë Kolegjit.

4. Nga shqyrtimi i këtyre akteve, në raport me secilin shkak ankimi, konstatojmë për sa vijon:

4.1 Për shkakun ankimor lidhur me *pasurinë apartament 102 m²*, në rrugën “**** ****”, Tiranë, nga aktet e vëna në dispozicion, është përcjellë dokumentacioni në vijim:

(i) Shkresë nr. ****/**** prot., datë ****.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, ku parashtrohet se për periudhën në të cilën subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë kësaj Prokurorie, nuk ka pasur të regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasve **** **** dhe **** ****.

(ii) Shkresë nr. ****/**** prot., datë ****.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, ku parashtrohet se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat manualë dhe elektronikë, që nga viti 2015 e në vazhdim, në këtë Prokurori nuk është regjistruar asnjë material kallëzues, referues apo procedim penal në emër të shtetasve **** **** dhe **** ****.

(iii) Shkresë nr. ****/**** prot. datë ****.5.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Jug, e cila ka vënë në dispozicion praktikën e plotë të pasurisë nr. ****/****+****_****, vol. ****, f. ****, z. k. ****, regjistruar nga subjekti ndërtues “**** ****” sh.p.k., me leje ndërtimi nr. ****, datë ****/12/2004. Në pronësi të **** ****, pasuria është regjistruar me kontratën e shkëmbimit nr. **** rep., dhe nr. ****/**** kol., datë ****.8.2010, nga noteri publik, ndërsa, në emër të z. Petrit Çano, pronësia ka kaluar me kontratën noteriale të shitjes nr. **** rep., nr. ****/**** kol., datë ****/12/2011.

(iv) Shkresa nr. ****/**** prot., datë ****.5.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, e cila, në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, konfirmon se *detyrimi që ka rezultuar në vlerën prej 110.000 lekë, në datën ****.2.2019, për subjektin “****” sh.pk., i përket detyrimeve për deklarata të padorëzuara, të cilat i përkasin periudhës 2014-2016, detyrime pas datës së aplikimit për çregjistrim të subjektit.*

4.1.1 Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë së tyre, vërejmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit rezulton e verifikuar, duke munguar elementet e një gjendjeje të tillë.

4.1.2 Për sa i përket vlerësimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave të deklaruara për periudhën 2006 - 2009, me burim fitimi nga aktiviteti i bashkëshortes ****. ****., aktet e depozituara konfirmojnë se detyrimi në shumën 110.000 lekë, në datën ****.2.2019, i përket deklaratave tatimore të padorëzuara për periudhën 2014 – 2016, dhe si i tillë, nuk ka ndikim në burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, të përdorura për blerjen e *pasurinë apartament 102 m²* të likuiduar deri në muajin dhjetor 2011.

4.2 Për shkakun ankimor lidhur me *pasurinë apartament 63 m²*, në rrugën “**** ****”, Tiranë, nga aktet e vëna në dispozicion, është përcjellë dokumentacioni në vijim:

(i) Shkresë nr. ****/**** prot., datë ****.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, ku parashtrohet se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat manualë dhe elektronikë, që nga viti 2015 e në vazhdim, në këtë Prokurori nuk është regjistruar asnjë material kallëzues,

Prokurorisë, në pamundësi të marrjes së informacionit nëse ankimi mund të jetë paraqitur nga ana e kërkuesve/të dënuar për ato vendime gjyqësore, që kanë disponuar pushim gjykimi ose mospranim kërkese.

(iii) Sipas tabelës rezulton se, për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës **“Qëndrim në shtëpi”**, Gjykata ka disponuar me 16 pranim kërkese dhe është ushtruar 1 ankim; për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës **“Lirim me kusht”**, Gjykata ka disponuar me 43 pranim kërkese dhe janë ushtruar 9 ankime; për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës **“Rillogaritje paraburgimi”**, Gjykata ka disponuar me 14 pranim kërkese dhe nuk është ushtruar asnjë ankim; për kërkesat e paraqitura me objekt zbatimin e dispozitës **“Njohje amnistie”**, Gjykata ka disponuar me 18 pranim kërkese dhe janë ushtruar 2 ankime.

(iv) Shkresë nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në të cilën janë bashkëlidhur aktet e nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, për vitin 2017, 2019 dhe 2020, si më poshtë:

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 1, datë 1.2.2017, “Për organizimin dhe Koordinimin e Punës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 2, datë 1.2.2017, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 3, datë 7.2.2017, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, në fazën e hetimeve”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 4, datë 9.2.2017, “Mbi ndarjen, administrimin, përfaqësimin, informimin dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, të kërkesave të paraqitura në fazën e ekzekutimeve të dënimeve penale”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 1, datë 7.1.2019, “Mbi përgjimet”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 2, datë 7.1.2019, “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale”;

- Udhëzim i Përgjithshëm nr. 1, datë 4.9.2020, “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë”;

- Udhëzim i datës ***.11.2017, “Në lidhje me vendimin nr. *** akti, datë ***.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për të dënuarin ***. ***.”;

- Lista e procesverbaleve për hedhjen e shorteve për kërkesat e veçanta, për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, mbajtur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë (gjithsej 79 fletë).

4.4.1 Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë së tyre, vërejmë sa vijon:

4.4.1.1 Lidhur me ushtrimin e ankimit kundër vendimeve të Gjykatës për pranim kërkese të dënuarit/kërkuesit, me objekt zbatimin e dispozitës, me objekt: **“Qëndrim në shtëpi”**, **“Lirim me**

kusht”, “*Rillogaritje paraburgimi*”, “*Njohje amnistie*”, vërejmë se në total, për periudhën ***.1.2016 deri aktualisht, Gjykata ka vendosur pranim kërkesë për 91 çështje, nga të cilat, për 12 prej tyre është ushtruar ankim. Rezulton, me kaq informacion sa është përcjellë nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, se ankimet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë janë të një niveli të ulët në raport me pranimet e kërkesave të të dënuarve nga Gjykata dhe me problematikën tërësore të hasur gjatë shqyrtimit të vendimit të KLP-së, të cilit iu referuam për këtë kërkim.

4.4.1.2 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, ndër të tjera, ka nxjerrë Udhëzimin e përgjithshëm nr. 1, datë 1.2.2017,² “*Për organizmin dhe koordinimin e punës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë*” dhe Udhëzimin e përgjithshëm nr. 4, datë 9.2.2017, “*Mbi ndarjen, administrimin, përfaqësimin, informimin dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë, të kërkesave të paraqitura në fazën e ekzekutimeve të dënimeve penale*”.

4.4.1.3 Në Udhëzimin e përgjithshëm nr. 1, datë 1.2.2017, parashikohet rregullimi që për kërkesat e veçanta të paraqitura nga të dënuarit, Drejtuesi i Prokurorisë ka të drejtë të vihet në dijeni për konkluzionet me shkrim të prokurorit të çështjes, për të cilat mund t’i sugjerojë prokurorit mendimin e tij, i cili mund të merret ose jo në konsideratë nga prokurori i çështjes, sugjerimi shënohet te konkluzionet e prokurorit dhe bëhet pjesë e fashikullit³.

4.4.1.4 Gjithashtu, në Udhëzimin nr. 4, datë 9.2.2017, parashikohet rregullimi që Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për prokurorët e Prokurorisë për përfaqësimin në gjykatë, në rastet e gjykimit të kërkesave të paraqitura nga të dënuarit. Udhëzimet jepen me shkrim të arsyetuara ose verbalisht⁴.

4.4.1.5 Në zbatim të këtyre rregullimeve normuese të veprimtarisë së Prokurorisë rezulton se, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit, për periudhën pas datës 1 gusht 2017,⁵ ka dalë me udhëzim⁶ vetëm për 1 çështje⁷, e cila është një ndër katër çështjet objekt i procedimit disiplinor të prokurorit ***. ***, prokuror i Prokurorisë Krujë, përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4.4.1.6 Ndërkohë, për periudhën para datës 1 gusht 2017, kur subjekti i rivlerësimit, për shkak të dispozitave të asaj kohe në Kodin e Procedurës Penale, ka pasur cilësinë e prokurorit epror, nuk ka të dhëna specifike se sa janë çështjet për të cilat ka vendosur Gjykata dhe sa janë ankimet që i përkasin kësaj periudhe, të ushtruara nga ana e organit të Prokurorisë.

² Nxjerrë në zbatim të nenit 46, pika 3, germa “c” dhe Udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm.

³ Referohuni pikës 4, 5 dhe 6 të Udhëzimit të përgjithshëm nr. 1, datë 1.2.2017.

⁴ Referohuni pikës 9 të Udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 9.2.2017.

⁵ Ligji nr. 37/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë” ka hyrë në fuqi më datë 1 gusht 2017.

⁶ Referuar Udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, Kreu II, pika 2.3. e Prokurorit të Përgjithshëm.

⁷ Udhëzim në lidhje me vendimin nr. *** akti, datë ***.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për të dënuarin *** **.

5. Lidhur me hetimin dhe verifikimin, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, mbi denoncimin e paraqitur në Kolegj nga shtetasi ***. ***, nga aktet e përcjella nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Gjirokastër, Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve Gjirokastër, Vlorë dhe Lushnjë nuk rezultojnë pasuri apo kontrata në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA